

V E N D I M
Nr.394, datë 15.8.2002

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E POGRADECIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20, dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të nenit 29 pika 1 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve të cilët preken nga ndërtimi i varrezave publike në Bashkinë e Pogradecit.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Pogradecit.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 5855 m2 tokë/arë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 5 855 000 (pesë milionë e tetëqindpesëdhjetë pesë mijë) lekësh.
 4. Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2002, zëri “Investime”, t’i shtohet fondi prej 5 855 000 lekësh, i cili i pakësohet buxhetit të vitit 2002, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 163 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, miratuar për Bashkinë e Pogradecit, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 15-20 shtator 2002.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Financave, Prefektura e Qarkut të Korçës dhe Bashkia e Pogradecit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano